

ES SIRAAT (rruga)

Vullnet MERJA

Fjala "siratun", rrugë, në Kur'anin e shenjtë përmendet 45 herë. Në të gjitha rastet ajo përmendet formën e emrit të prejardhur nga folja (masdarun). Kjo formë përmendje ka ardhur në Kur'an që të tregojë për një rrugë të veçantë të të menduarit, ndryshe nga rrugët e tjera. Kjo rrugë është Islami, i cili bazohet në adhurimin e Allahut të Vetëm e të Pashoq, siç thuhet në suren "Ali Imran", ajeti 51: **"Me të vërtetë, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhurojeni Atë. Kjo është rruga e drejtë!"**

Në tridhjetë e katër vende, nga dyzet e pesë që përmendet në Kur'an, fjala "sirat" shoqërohet me fjalën "el istikamet", i/e drejtë. Kjo është një thirrje për të gjithë njerëzit që të ecin në këtë rrugë të pastër nga devijimi dhe shtrembërimi.

Nëse do të thellohemi në ajetet e Kur'anit të cilat përmendet fjala "sirat" do të vërejmë se kjo fjalë përmendet me kuptimin ideologjik e mendor dhe jo lëndor e material.

Në Kur'an përmendet edhe fjala "sebil" (rrugë). Kjo fjalë dallon nga fjala "sirat" sepse mund të thuhet "fi sebililah", në rrugën e Allahut, dhe "fi sebilja gajrilah", në rrugë tjetër përveç rrugës së Allahut. Kurse fjala "sirat" përdoret vetëm për rrugën e drejtë që është rruga e Allahut. Gjithashtu fjala "sebil" ka ardhur edhe në numrin shumë "subul", rrugët, siç thuhet në ajetin 69 të sures "Ankebut": **"Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt rrugëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!"** Ndërsa fjala Sirat përdoret përmendet vetëm në numrin njëjës.

"Udhëzona në rrugën e drejtë"¹

Pasi njeriu dëshmon se është rob i Allahut dhe i përulet vetëm Ati dhe askujt tjetër, kërkesa e parë që kërkon prej Krijuesit të tij është udhëzimi në rrugën e drejtë, në rrugën e pastër, në rrugën e drejtësisë dhe mirësisë, në rrugën e imanit dhe të veprave të mira, me qëllim që All'Ilahu t'i dhurojë udhëzimin ashtu siç dhuron mirësitë e tjera. Besimtari, i cili ndjek këtë rrugë, gjithmonë përballet me shkaqe të cilat e çojnë në devijim dhe në zhveshjen prej mirësisë së udhëzimit në rrugë të drejtë. Për këtë, është e domosdoshme që ai t'i kërkojë vazhdimisht All'Ilahut të Madhëruar që ta mbrojë prej gjynaheve dhe devijimeve. dhe të mbështetet tek All'Ilahu dhe Atij t'i kërkojë ndihmë.

Cila është rruga e drejtë?

Kjo rrugë sipas ajeteve të Kur'anit është feja e teuhidit (monoteizmit) dhe zbatimi i urdhërave të All'Ilahut. Ajo është feja e vërtetë, rruga e profetit Ibrahim (*paqja qoftë mbi të!*) dhe mohimi i të gjitha llojeve të politeizmit, siç thuhet në thënien e All'Ilahut në Kur'an: **"Thuaj: Mua më udhëzoi All'Ilahu në rrugën e drejtë dhe nuk ka qenë prej politeistëve."**²

Dhe: **"Ai që i përmbahet fesë së All'Ilahut, vërtet është udhëzuar në rrugën e drejtë."**³

Duhet theksuar se rruga e drejtë është një e jo më shumë, sepse në mes dy ekstremeve nuk gjindet tjetër gjë por, vetëm një vijë e drejtë, e cila është më e shkurtëra. Nga këtu themi se, kuptimi i rrugës së drejtë sipas Kur'anit është feja e All'Ilahut, sepse kjo rrugë

¹ Sure "Fatihah", ajeti 7.

² Sure "En'am", ajeti 161.

³ Sure "Ali Imran", ajeti 101.

është më e afërta në lidhjen me All'llahun e Madhëruar. Po ashtu, edhe feja e vërtetë është një dhe jo më shumë. Këtë e dëshmon edhe Kur'ani i shenjtë, i cili thotë: **“Vërtet feja tek All'llahu, është Islami”**⁴

Duhet të dihet se fjala Islam ka kuptim të gjerë dhe përfshin çdo fe të njëshmërisë. Disa thonë se rruga e drejtë është Islami. Disa të tjerë thonë se është Kur'ani. Disa të tjerë thonë se janë të dërguarit. thonë se është feja e All'llahut, Islami, përveç së cilës Ai nuk pranon asnjë fe tjetër. Të gjitha këto thënie kanë një kuptim të vetëm që është feja e All'llahut të Madhëruar, me të dyja anët e saj, ideologjike dhe praktike. Profeti Muhammed (*paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: **“Udhëzoni në rrugën e drejtë”. Ajo është rruga e të dërguarve me të cilën All'llahu i mirësoi ata.**⁵

Ragib El Asfahani në librin e tij “El-Mufredatë” thotë se fjala “sirat” përmban istikamentin (kërkimin, ecjen në rrugën e drejtë) dhe cilësimi i saj “mustekim” është dëshmi për këtë cilësi.

Fjala “Sirat” në ajetet e Kur'anit

Allahu i Madhëruar thotë: **“Udhëzoni në rrugën e drejtë”**⁶

Dhe: **“Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi...”**⁷

Dhe: **“...Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi. Ai udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë”**⁸

Dhe: **“...Allahu shpie në udhë të drejtë kë të dojë.”**⁹

Dhe: **“Me të vërtetë, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj adhurojeni Atë. Kjo është rruga e drejtë!”**¹⁰

Dhe: **“...Kush mbahet fort pas (fesë së) Allahut, sigurisht që është i drejtuar në udhë të drejtë.”**¹¹

Dhe: **“... me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë.”**¹²

Dhe: **“...Allahu shpie në humbje kë të dojë dhe udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë.”**¹³

Dhe: **“Ne zgjodhëm dhe udhëzuam në rrugë të drejtë edhe disa nga paraardhësit, pasardhësit dhe vëllezërit e tyre.”**¹⁴

⁴ Sure “Ali Imran”, ajeti 19.

⁵ Tefsiri; “Nuru Thakalejn”: vëll.1 f.20 dhe 21.

⁶ Sure “Fatiha”, ajeti 7.

⁷ Sure “Fatiha”, ajeti 7.

⁸ Sure “Bekare”, ajeti 142.

⁹ Sure “Bekare”, ajeti 231.

¹⁰ Sure “Ali Imran”, ajeti 51.

¹¹ Sure “Ali Imran”, ajeti 101.

¹² Sure “Maide”, ajeti 16.

¹³ Sure “En’am”, ajeti 39.

Dhe: “Kjo është rruga e drejtë e Zotit tënd...”¹⁵

Dhe: “Kjo është rruga Ime e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera që t’ju shmangin nga rruga e Tij. Kjo është ajo që ju porosit Ai për t’u ruajtur nga të këqijat.”¹⁶

Dhe: “Thuj: “Me të vërtetë, Zoti im më ka udhëzuar në rrugë të drejtë...”¹⁷

Dhe: “Ai (djalli) tha: “Për shkak se Ti më flake tej, unë do t’u zë pritë njerëzve në rrugën Tënde të drejtë.”¹⁸

Dhe: “Mos zini pusi në çdo rrugë...”¹⁹

Dhe: “...dhe udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë.”²⁰

Dhe: “...Me të vërtetë, Zoti im, është në rrugë të drejtë.”²¹

Dhe: “...në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd.”²²

Dhe: “(Allahu) tha: “Kjo është rruga Ime e drejtë.”²³

Dhe: “...A është i barabartë ky me atë që urdhëron për drejtësi dhe ndjek rrugën e drejtë?”²⁴

Dhe: “(por ka qenë) mirënjohës ndaj dhuntive të Tij. Ai e zgjodhi atë dhe e udhëzoi në rrugë të drejtë.”²⁵

Dhe: “(Isai tha): “Vërtet, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj; andaj adhuroni vetëm Atë! Kjo është udha e drejtë.”²⁶

Dhe: “...prandaj ndiqmë mua dhe unë do të të udhëzoj në rrugën e drejtë!”²⁷

Dhe: “...dhe do ta kuptoni se kush janë ithtarët e rrugës së drejtë dhe kush është i udhëzuar drejt.”²⁸

Dhe: “...dhe në rrugën e Atij që është i Denjë për t’u lavdëruar.”²⁹

Dhe: “...Nuk ka dyshim se Allahu i udhëzon në rrugën e drejtë ata që besojnë.”³⁰

¹⁴ Sure “En’am”, ajeti 87.

¹⁵ Sure “En’am”, ajeti 126.

¹⁶ Sure “En’am”, ajeti 153.

¹⁷ Sure “En’am”, ajeti 161.

¹⁸ Sure “A’raf”, ajeti 16.

¹⁹ Sure “A’raf”, ajeti 86.

²⁰ Sure “Junus”, ajeti 25.

²¹ Sure “Hud”, ajeti 56.

²² Sure “Ibrahim”, ajeti 1.

²³ Sure “Hixhr”, ajeti 41.

²⁴ Sure “Nahl”, ajeti 76.

²⁵ Sure “Nahl”, ajeti 121.

²⁶ Sure “Merjem”, ajeti 36.

²⁷ Sure “Merjem”, ajeti 43.

²⁸ Sure “Taha”, ajeti 135.

²⁹ Sure “Haxh”, ajeti 24.

³⁰ Sure “Haxh”, ajeti 54.

Dhe: “Ti i fton ata në rrugën e drejtë.”³¹

Dhe: “por ata që nuk besojnë jetën tjetër, shmangen nga rruga e drejtë.”³²

Dhe: “Tashmë Ne kemi zbritur shpallje të qarta; Allahu udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë.”³³

Dhe: “...e cila të udhëzon në rrugën e të Plotfuqishmit dhe të Denjit për çdo lavd.”³⁴

Dhe: “në rrugë të drejtë.”³⁵

Dhe: “por të më adhuron vetëm Mua?! Kjo është rruga e drejtë.”³⁶

Dhe: “Sikur të donim, Ne do t’ua verbonim atyre sytë, kështu që ata do ta kërkonin më kot rrugën! Vallë, si do të shihnin?”³⁷

Dhe: “krahas Allahut e tregojuni atyre rrugën e Zjarrit flakërues!”³⁸

Dhe: “i udhëzuam në rrugën e drejtë.”³⁹

Dhe: “...por na udhëzo në rrugë të drejtë.”⁴⁰

Dhe: “...Ti, me të vërtetë, udhëzon në rrugën e drejtë.”⁴¹

Dhe: “(në) rrugën e Allahut, të Cilit i përket gjithçka që ndodhet në qiej dhe gjithçka që ndodhet në Tokë...”⁴²

Dhe: “...sepse ti, në të vërtetë, je në rrugën e drejtë.”⁴³

Dhe: “...Pra, ndiqmëni mua, kjo është rruga e drejtë.”⁴⁴

Dhe: “Pa dyshim, Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, andaj adhuron vetëm Atë! Kjo është rruga e drejtë.”⁴⁵

Dhe: “A është më mirë ai që shkon rrëshqanas e kokulur apo ai që ecën ballëlart në rrugën e drejtë?”⁴⁶

Dhe: “dhe me siguri do t’i udhëzonim në rrugë të drejtë.”⁴⁷

Dhe: “...dhe do t’i udhëzojë drejt Vetes përmes rrugës së drejtë.”⁴⁸

³¹ Sure “Mu’minun”, ajeti 73.

³² Sure “Mu’minun”, ajeti 74.

³³ Sure “Nur”, ajeti 46.

³⁴ Sure “Sebe”, ajeti 6.

³⁵ Sure “Ja Sijn”, ajeti 4.

³⁶ Sure “Ja Sijn”, ajeti 61.

³⁷ Sure “Ja Sijn”, ajeti 66.

³⁸ Sure “Safat”, ajeti 23.

³⁹ Sure “Safat”, ajeti 118.

⁴⁰ Sure “Sad”, ajeti 22.

⁴¹ Sure “Shura”, ajeti 52.

⁴² Sure “Shura”, ajeti 53.

⁴³ Sure “Zuhruf”, ajeti 43.

⁴⁴ Sure “Zuhruf”, ajeti 61.

⁴⁵ Sure “Zuhruf”, ajeti 64.

⁴⁶ Sure “Mulk”, ajeti 22.

⁴⁷ Sure “Nisa”, ajeti 68.

⁴⁸ Sure “Nisa”, ajeti 175.

Dhe: “...për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në rrugën e drejtë.” ⁴⁹

Dhe: “...të jetë një shenjë për besimtarët e vërtetë dhe që t’ju udhëzojë në rrugën e drejtë.” ⁵⁰

⁴⁹ Sure “Fet’h”, ajeti 2.

⁵⁰ Sure “Fet’h”, ajeti 20.

